



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur ne nenin 11, nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 17 paragrafi 1 pika 0) nenit 40 pika i) të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale 20.02.2008/, Ligjit Nr. 04/L-071 për sistemin e adresave, Udhezimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 Për krijimin dhe administrimin e Listes Alfabetike për emertime, Listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal të adresave, si dhe nenit 40. paragrafi 2 nen piken 8) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit me nr prot. 01-015-1809/22 Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2022 të mbajtur me 28.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për

Formimin e Komisionit për emrimin dhe riemrimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës

1. Formohet Komisioni për emrimin dhe riemrimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës në përberje prej (9) anëtarëve.

- 1.1. Ilirjana Toplanaj - KK anëtare
- 1.2. Kushtrim Haliti - KK “
- 1.3. Marigona Racaj - KK “
- 1.4. Lirie Gashi -KK “
- 1.5. Gazmend Dauti - përfaqësues nga komuniteti joshumicë “
- 1.6. Gjyle Halili - Qendra Rinore “Ardhmerija” -përfaqësues nga Shoqria Civile “
- 1.7. Ali Raci - Historijan “
- 1.8. Shani Toqani - Gjeograf “
- 1.9. Alban Gashi - Përfaqësues nga mbrojtja e trashigimis kulturore “

2. Anëtarët e komisionit nga pika 1 e këtij vendimi zgjedhen për mandat- kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Kuvendit Komunal.
3. Kryesuesit dhe zëvendës kryesuesi i komisionit zgjedhen nga radhët e anëtarëve të komisionit me shumicë votash.
4. Detyrë e Komisionit nga pika 1 e këtij vendimi është: shqyrtimi i kërkesave për emertime të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike dhe pregaditja e propozimeve bazuar në kriteret përkatëse të përcaktuara me ligje dhe akte tjera nënligjore në fuqi, për Kuvendin e Komunës për marrjen e vendimit.

5. Mbeshtetje nga pika 1 e ketij vendimi do të ofroji DUMM e sipas kerkesës edhe njesitë-drejtoritë tjera varsisht nga kerkesat.
6. Për zbatimin e ketij vendimi do të kujdesët Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Klinë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe pas publikimit në ueb faqën zyrtare të Komunës, konform Rregullores se QRK nr.06/2021

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr 06-3499 /2022
Klinë me 02, 02 /2022



KRYESUESI,
Fadil Gashi